



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’ Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Termt e Referencës

Pozicioni:	Ekspert lokal
Vendodhja:	Shqipëri
Fillimi i Punës:	15.11.2021
Mbarimi i Punës:	12.12.2021
Kohëzgjatja:	18 ditë punë

Projekti

Ditët e sotme burgjet janë mjedise multi-etnike. Diversiteti etnik dhe kulturor i të burgosurve paraqet sfida të shumëfishta për stafin e vijës së parë në burgje, të cilët përballen më kultura e gjuhë të “panjohura”, fenomenin e nën-kulturës dhe episode të mundshme radikalizimi dhe ekstremizmi. Menaxhimi i aspekteve multi-kulturore në ambientet e burgjeve është një çështje prioritare në legjislacionin e BE-së, siç theksohet edhe në Rekomandimin Cm/ Rec (2012)12 të Këshillit të Ministrave. Nisur nga kjo ka lindur nevoja që stafi i burgjeve të marrë trajnimet e duhura për tu përballur me nevojat dhe të drejtat e të burgosurve të huaj. Në këtë kuadër, projekti 2 vjeçar “B-ComPetent – Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe” ka për qëllim të kontribuojë në aplikimin koherent dhe efektiv të legjislacionit dhe standardeve të BE lidhur me trajtimin e të burgosurve të huaj nëpërmjet ndërtimit dhe implementimit të një programi të tipit “train-the-trainers” (ballë-për-ballë dhe e-learning), kombinuar me praktikën më të mira, aksione për rritjen e ndërgjegjësimit dhe mjeteve praktike multi-gjuhësore. Avokati i Popullit në bashkëpunim me gjashtë partner, janë duke implementuar projektin nr. 854040 “*Boosting Competences in Penitentiary Staff in Europe*” i bashkë financuar nga Programi i Drejtësisë së BE (2014-2020).

Objektivi

Avokati i Popullit kërkon të rekrutojë një Ekspert, i cili do të angazhohet për hartimin e **“Final Evaluation Report” Produkti 1.7 në Paketën e Punës 1 (WP 1), në kuadër të projektit nr. 854040 B-ComPetent, “Boosting competences in penitentiary staff in Europe”, në Shqipëri.**

Detyrat dhe përgjegjësitë

Avokati i Popullit do të kërkojë kryerjen e shërbimit nga një Ekspert, i cili do të jetë përgjegjës për hartimin e një raportin përfundimtar të projektit në të cilin do të kryehet vlerësimi i të gjithë aktiviteteve të realizuara nga partnerët e konsorciumit. Eksperti do të jetë përgjegjës për hartimin e metodologjisë, mbledhjen e informacioneve nga partnerët, kryerjen e intervistave të detajuara me secilin partner, përpunimin e informacionit, përgatitjen e draft raportit, konsultimin me draft raportit me grupin teknik të projektit, si dhe hartimin raportit përfundimtar i cili do të dorëzohet pranë donatorit.

Kriteret e veçanta

- Ekspert në fushën juridike, preferohet të mbajë gradën shkencore.
- Të ketë eksperiencë në fushën e të drejtave të njeriut, me fokus të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve/ të dënuarve.
- Vlerësohet nëse eksperti ka pasur bashkëpunime të tjera të mëparshme në fushën e të drejtave.
- Vlerësohet që eksperti të ketë kryer hulumtime shkencore dhe të ketë pjesëmarrje në konferenca kombëtare/ndërkombëtare, si dhe të ketë kryer botime shkencore brenda e jashtë vendit.
- Të ketë njohje të thellë të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar.
- Të ketë aftësi organizative dhe administrative si dhe veçanërisht aftësi komunikimi
- Të ketë standarde të larta të integritetit dhe përvojës në trajtimin e informacionit konfidencial.

Aplikanti duhet të dorëzojë:

1. Letër motivimi
2. Curriculum vitae
3. Cdo dokument shtesë që lidhet me aplikimin.

Afati i aplikimit: 01 Nëntor 2021

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

Adresa: Avokati i Popullit, Bulevardi Zhan D’Ark nr. 2, Tiranë

